

LIGJI NR. 06/L-122**PËR MINISTRINË E MBROJTJES****Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR MINISTRINË E MBROJTJES**Neni 1
Qëllimi**

Më këtë ligj bëhet riorganizimi dhe kalimi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ministri të Mbrojtjes në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim të administrimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit civil demokratik mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe udhëhiqet nga Ministri i Mbrojtjes.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet për Ministrinë e Mbrojtjes, përfshirë strukturën dhe autoritetet brenda Ministrisë

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Për zbatim të këtij ligji, shprehjet dhe termet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet si vijon:

- 1.1. **Ministria** - Ministria e Mbrojtjes;
- 1.2. **FSK**- Forca e Sigurisë së Kosovës;
- 1.3. **Kushtetuta** - Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- 1.4. **Presidenti**- Presidenti i Republikës së Kosovës;
- 1.5. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;
- 1.6. **Kryeministri** - Kryeministri i Republikës së Kosovës;
- 1.7. **Ministri** - Ministri i Mbrojtjes;
- 1.8. **KOMFSK** -Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- 1.9. **Plani i vendosjes**- Plani i vend lokacioneve/kazermave të FSK-së.

**Neni 4
Ministria e Mbrojtjes**

1. Ministria e Mbrojtjes është organ i administratës shtetërore i përbërë nga nëpunësit civilë dhe

nga personeli ushtarak i FSK-së. Nëpunësit civilë të punësuar në Ministri dhe në FSK, përveç të emëruarave politikë, janë pjesë e shërbimit civil të Republikës së Kosovës dhe ruajnë parimin e ekuivalencës në shërbim dhe paga me gradat ushtarake, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Ministria ka strukturën e saj, të organizuar në drejtori, departamente, sektorë, njësi dhe zyra që sigurojnë funksionalizimin dhe përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të saj.

3. Ministria harton dhe zbaton politikat e përgjithshme shtetërore të mbrojtjes në nivelin strategjik, si dhe ushtron funksionet e kompetencat e saj, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

4. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në Ministri, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor, duke marrë parasysh këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 5 **Kompetencat e Ministrisë**

1. Ministria është kompetente për:

1.1. hartimin e dokumenteve strategjike të mbrojtjes;

1.2. hartimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore nga fushëveprimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së;

1.3. zhvillimin, bashkërendimin dhe hartimin e politikave për integrim dhe anëtarësim në strukturat ndërkombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës;

1.4. hartimin e politikave për zhvillimin, modernizimin dhe standardizimin e FSK-së;

1.5. hartimin e politikave për edukimin dhe trajnimin për gjithë personelin e Ministrisë të Mbrojtjes dhe FSK-së;

1.6. hartimin e programeve të bashkëpunimit me institucionet shtetërore në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë;

1.7. hartimin e politikave, sistemit, planeve dhe strategjive për menaxhimin e burimeve njerëzore të personelit ushtarak dhe civil në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-së;

1.8. planifikimin, programimin, buxhetimin dhe ekzekutimin e projekteve për nevojat e mbrojtjes;

1.9. bashkëpunimin me institucionet kompetente për përfaqësimin gjyqësor në mbrojtje të interesave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së;

1.10. mbikëqyrjen dhe menaxhimin e të gjitha veprimtarive të inteligjencës dhe informacioneve të klasifikuara në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;

1.11. zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve në fushën e bashkëpunimit civilo-ushtarak;

1.12. mbikëqyrjen dhe inspektimin e FSK-së;

1.13. menaxhimin e infrastrukturës dhe pajisjeve, të cilat i janë ndarë Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së;

- 1.14. zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve për logjistikë dhe infrastrukturë;
- 1.15. zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe organizimin e sistemeve të komunikimit;
- 1.16. zhvillimin dhe monitorimin e politikave, planeve dhe programeve mjekësore dhe përkujdesjes shëndetësore për personelin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së;
- 1.17. zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve lidhur me marrëdhëniet me publikun dhe protokollin;
- 1.18. hartimin e politikave për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe çështje të komuniteteve, në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së;
- 1.19. kryen edhe detyra të tjera, të përcaktuara me ligj dhe akte tjera nënligjore në fuqi

Neni 6 **Ministri i Mbrojtjes**

1. Ministri i Mbrojtjes:

- 1.1. përfaqëson Republikën e Kosovës në nivel ndërkombëtar në çështjet e mbrojtjes;
- 1.2. me propozim të KOMFSK miraton drejtimin e fondeve për FSK-në dhe obligon ekzekutimin e procedurave për shpenzimin e buxhetit të mbrojtjes;
- 1.3. propozon buxhetin e MM-se dhe FSK-së dhe mbikëqyr shpenzimet nga buxheti i miratuar;
- 1.4. i rekomandon Kryeministrit, në bashkëpunim me KOMFSK, programet e veçanta në fushën e mbrojtjes që kërkojnë mbështetje financiare;
- 1.5. inicion dhe propozon të gjitha dokumentet e nevojshme të politikave, planet afatgjata të zhvillimit lidhur me Forcën e Sigurisë së Kosovës për t'u shqyrtuar nga Qeveria dhe Këshilli i Sigurisë së Kosovës;
- 1.6. i propozon Kryeministrit, për miratim nga Presidenti, emërimin, gradimin, shkarkimin dhe lirimin nga detyra të Komandant të Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- 1.7. i propozon Kryeministrit planin e vendosjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës në kohë paqeje;
- 1.8. i propozon Kryeministrit strukturën organizative të Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- 1.9. inspekton FSK-në, përmes inspektorit gjeneral të FSK-së.

2. Ministri, në konsultim me Kryeministrin, sipas rekomandimit të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, i propozon Presidentit:

- 2.1. emërimet, gradimet, shkarkimet dhe lirimet në gradën e Gjeneralit, përveç, grades Gjenerallejtënant.
- 2.2. stemën e Forcës së Sigurisë së Kosovës, emblemat e njësive, dukjen e gradave dhe uniformave të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

3. Ministri, në koordinim me KOMFSK, propozon emërimet dhe tërheqjen e atasheve ushtarakë pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës;

4. Ministri, ushtron edhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 7 **Zyrtari Kryesor Administrativ**

1. Zyrtari Kryesor Administrativ i MM është Sekretari i Përgjithshëm si udhëheqësi më i lartë administrativ i Ministrisë dhe i raporton drejtpërdrejt Ministrit.

2. Sekretari i Përgjithshëm, në veçanti ka këto përgjegjësi dhe kompetenca:

2.1. menaxhon nëpunësit civilë dhe të uniformuar të Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës që punojnë brenda Minsitrisë së Mbrojtjes;

2.2. menaxhon financat dhe burimet tjera të ministries dhe FSK-së, si dhe siguron ekzekutimin e procedurave administrative për menaxhimin e buxhetit të MM-së dhe FSK-së;

2.3. kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 8 **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj nxirren në afat prej më së largu një (1) vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Aktet nënligjore që janë në fuqi vazhdojnë të zbatohen, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 9 **Dispozitat e kalimtare**

Të gjitha ndryshimet e parapara me këtë ligj do të bëhen konform fazave të përcaktuara në rekomandimet e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë dhe të detajuara në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit.

Neni 10 **Shfuqizimi**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen:

1.1. Ligji Nr. 03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 26/ 02 qershor 2008);

1.2. Ligji nr. 03/L-107 për Ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës nr. 03/L- 045, (gazeta zyrtare / nr. 42 / 25 nëntor 2008);

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L-122
14 dhjetor 2018

Shpallur me dekretin Nr. DL-066-2018, datë 28.12.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi